



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 55/1 prot.

Tiranë, më 24. 01. 2022

V E N D I M

Nr. 29, datë 24. 01. 2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 03 regj, datë 10.01.2022, të paraqitur nga subjekti ankues, Gj. Ll., kundër A. I., në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe çdo shkak tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Gj. Ll., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon se, ka ushtruar detyrën e Përgjegjës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Në mesin e muajit prill 2019, në rrjetin social facebook, ka përshëndetur me disa fjalë deputetin e opozitës, L. M., i cili ka mbajtur më parë (deri në muajin mars 2019), pozicionin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Dy ditë më pas, më datë 17.04.2019, ai është vënë në dijeni të një e-maili të dërguar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, A. I., i cili e ka njoftuar se veprimi i tij (komenti drejtuar deputetit L. M.), është në shkelje të etikës dhe për pasojë ndaj tij do të duhet të mbaheshin qëndrime disiplinore. Gjithashtu, në e-mail-in e sipërcituar, ankuesit i është kërkuar informacion nëse adresa e faqes së facebook-ut, është e tija apo jo.

Pas kundërshtimit të veprimeve të sipërcituara, ankuesi pretendon se A. I. ka filluar ta trajtojë në mënyrë të pafavorshme, duke iniciuar ndaj tij procedurën disiplinore dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Ankuesi thekson se, për periudhën prej më pak se 5 muaj, gjatë së cilës ka punuar me A. I., puna e tij është vështirësuar, pasi i janë ngarkuar detyra jashtë përshkrimit dhe orarit zyrtar të punës. Fillimisht ai pretendon se nga ana e A. I. është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor për

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

shkelje të rënda, e më pas një ditë më vonë këto shkelje janë konvertuar në shkelje shumë të rënda. Sipas ankuesit, procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, jo vetëm që nuk ishte respektuar, por ishte ngritur bazuar në “shpifje, trillime, apo deformime skandaloze”. Megjithatë në fillim të muajit korrik 2019, ankuesi thekson se i janë zgjidhur marrëdhëniet punës me punëdhënësin. Për këtë ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë² dhe asaj të Apelit³, të cilat kanë vendosur shfuqizimin e urdhërit të A. I., për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe rikthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Në vijim ankuesi ka cituar në ankesë ndër të tjera se: “...Kalvari i vuajtjeve të mija dhe përndjekja ndaj meje, ka filluar në periudhën kohore prej afro 2.5 vjetësh nga momenti i përpilimit të kësaj ankese, dhe pikërisht në kohën kur drejtues i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, është caktuar A. I. Mjaftuan afro 5 muaj në këtë detyrë, që ky drejtues i lartë të fillonte ndaj meje sulme të paprecedentë në jetën time profesionale, madje edhe private. Si pasojë e veprimeve të tij, mua më janë shkaktuar pasoja shumë të rënda personale, shëndetësore dhe familjare, aq sa është rrezikuar seriozisht jeta ime...Përpyekjet e tij si drejtues i DPB-së për të më diskriminuar, kanë vijuar edhe pas fillimit të veprimeve përmbartimore për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Megjithëse vendimmarrja gjyqësore është tepër e qartë, nga ana e këtij titullari, pavarësisht “njoftimi për ekzekutim vullnetar” dhe “vendimit për ekzekutim të detyrueshëm” të përmbartuesit gjyqësor, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për kthimin tim në punë, në vendim e mëparshëm, apo në një pozicion të barazvlefshëm me të, deri në datën 20.12.2021 që ai dorëzoi detyrën... Në DPB dhe institucionet e tjera të sistemit, janë mbajtur të paplotësuara (vakante) për muaj e vite të tëra, 227 pozicione pune, të cilat kanë funksionuar me njerëz të komanduar, por ka zënë vetëm vendim tim të punës në Nëntor 2020, duke manipuluar dhe DAP-in, megjithëse ky pozicion ishte ‘barrë gjyqësore’ (çështja po gjykohej në apel), duke paguar për pasojë dy veta për një vend pune. Ky veprim i paligjshëm është bërë qëllimisht për të mbyllur mundësitë e rikthimit në vendin e punës”.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të bindjeve politike dhe çdo shkak tjetër, si dhe:

- t'i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë, me rekomandim për marrjen e masave maksimale dhe sanksioneve administrative, ndaj A. I.;
- të urdhërojë Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, atë të drejtuesit të Njësisë së Auditimit;
- të urdhërojë Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për dhënien e një ndihme ekonomike/financiare, lidhur me situatën e rëndë shëndetësore të tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

² Vendimi Nr. 136 (80-2020-137), datë 22.01.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³ Vendimi Nr. 513, datë 14.10.2021 të Gjykatës së Apelit Administrativ

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*bindjes politike*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

- **Në lidhje me situatën diskriminuese të pretenduar**

Referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese*”, ankesa e Gj. Ll., nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Nga aktet e administruara, rezulton se ankuesi pretendon se ndaj tij është kryer sjellje diskriminuese në periudhën prill-gusht 2019. Pavarësisht këtij fakti, rezulton se lidhur me sjelljen

diskriminuese me të cilën ai pretendon se është përballur, ka marrë dijëni së fundmi në datën 19.08.2019, kur i është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi.

Në kontekst të sa mësipër, ankuesi ka marrë dijëni për sjelljen diskriminuese të pretenduar, që në datë 19.08.2019. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 10.01.2022, pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni.

Pra, në përfundim Komisioneri konstaton se janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Në lidhje me pretendimin për rikthimin në punë, në zbatim të vendimmarrje së Gjykatës Administrative të Apelit

Komisioneri vlerëson se pretendimet e subjektit ankues janë bërë objekt shqyrtimi nga gjykata, e cila ka dalë me vendimin përkatës. Po ashtu, Komisioneri vëren se dhe detyrimi i zbatimit të vendimit të gjykatës⁴ nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj. Të njëjtin qëndrim Komisioneri ka mbajtur edhe në shqyrtimin e ankesës Nr. 67, datë 13.04.2021, të paraqitur nga E.V.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

Komisioneri i sugjeron ankuesit se, bazuar në Ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, “*Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor*”, dhe atë nr.10031, datë 11.12.2008 “*Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat*”, mund t'i drejtohet këtyre institucioneve, që janë dhe organet kompetente, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe “dh” të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi Gj. Ll. kundër A. I. në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit, paraqitet mëvonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Subjekti ankues pavarësisht mospranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në

⁴ Në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 36, pika 1: “Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç/dh dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, Gj. Ll., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindje politike dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)